

## Përmbajtja

1. Rreth Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës
2. Misioni
3. Vizioni
4. Mesazhi i drejtorit
5. Performanca dhe arritjet e DAK-së
6. Organizma të akredituar
7. Bashkëpunimi në nivel Evropian dhe ndërkombëtar i DAK-së
8. Trajnimet e stafit, Vlerësuesit dhe Ekspertët Teknik
9. Takimet rajonale të DAK-së
10. Organograma
11. Materialet promovuese
12. Ueb faqja
13. Shtypi ditor shkruan

## Content

1. About Kosovo Accreditation Directorate
2. Mission
3. Vision
4. Message of the Director
5. Performance and achievements of the DAK
6. Accredited bodies
7. Cooperation of DAK at international and European level
8. Training of staff, Assessors and Technical Experts
9. Regional Meetings of the DAK
10. Organizational Structure
11. Promotional materials
12. Website
13. The daily press writes

## Rreth Drejtorisë së Akreditimit

Drejtoria e Akreditimit të Kosovës (DAK) është i vetmi Organ Kombëtar i Akreditimit, i njohur nga qeveria, për të vlerësuar në përputhje me standardet ndërkombëtare kompetencën teknike të Organeve të Vlerësimit të Konformitetit që kryejnë aktivitete të tillë si: testim, kalibrim, certifikim, dhe inspektim qofshin në sektorët publik apo privat, të fushës vullnetare apo të detyrueshme.

Drejtoria e Akreditimit e Kosovës funksionon në bazë të Ligjit Nr. 03/L- 069, i cili më datë

28.06.2011 është amendamentuar - Ligji 04/L 007, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ 2009/02.

DAK u krijua në mënyrë që të mbështesë zbatimin e rregullave teknike të cilat përcaktojnë sigurinë e produkteve dhe lëvizjen e lirë të mallrave në tregun e brendshëm dhe të jashtëm, mbrojtjen shëndetësore të qytetarëve, mbrojtjen e konsumatorëve, mbrojtjen e mjedisit dhe fushave të tjera relevante të interesit publik.

## About Accreditation Directorate

Directorate of Accreditation of Kosovo (DAK) is the only National Accreditation Body, recognized by Government, which in accordance to international standards, assesses technical competences of the Conformity Assessment Bodies that deal with activities such as: testing, calibration, certification and inspection both in public and private sector, in voluntary and mandatory fields. Directorate of Accreditation of Kosovo operates in accordance to Law No 03/L- 069, which was

amended on 28.06.2011 to Law No 04/L 007, and in accordance to Administrative Instruction No. 2009/02.

DAK has been established to support enforcement of technical regulations that determine product safety and free movements of goods in national and international market, health protection of citizens, protection of customers, protection of environment and other relevant fields of public interests.

## Misioni

Misioni i DAK-ut është t'ju ofrojë të gjitha palëve të interesuara, akreditimin mbi bazën e rregullave të përcaktuara në ligjet, standardet, rregullat teknike dhe në parimet e akreditimit.

## Vizioni

Vizioni i DAK-ut është që në një periudhë të afërt të bëhet anëtare me të drejta të plota në EA (European co-operation for Accreditation) si dhe të arrij të nënshkruaj marrëveshjen multilaterale me EA (EA MLA).

---

## Mission

The mission of DAK is to provide all interested parties with the accreditation based on regulations applicable by laws, standards, technical regulations and accreditation principles.

## Vision

The vision of DAK is to become full member of EA (European co-operation for Accreditation) and to sign the Multilateral Agreement (EA MLA) as soon as possible.

*Mesazhi i Drejtorit*

Msc. Ibush Luzha

Të nderuar lexues, me kënaqësinë më të madhe ju paraqes raportin vjetor të DAK-së për vitin 2011, me qëllim që të ju njoftoj me aktivitetet dhe progresin që DAK ka pasur gjatë këtij viti.

Viti 2011 ishte një ndër vitet më të bujshme të DAK-së, i përcjellë me aktivitete të ndryshme, si aspektin e hartimit të legjislacionit ashtu edhe në aspektin e ngritjes profesionale, përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të cilësisë, me qëllim të avancimit të DAK-së si Organ Akredituese si në rajon ashtu edhe më gjerë.

Në kuadër të hartimit të legjislacionit primar dhe sekondar dhe implementimit të tij, gjatë tremujorit të parë të vitit 2011 u bë amendamenti i ligjit Nr 03/L-069 për akreditim, i cili u harmonizua me rregulloren 765/2008. Tani Ligji i amenduar për Akreditim është Nr. 04/L 007. Po në këtë vit u hartua Udhëzimi administrativ për rregullimin e Këshillit të Akreditimit si dhe u hartuar Rregullorja e Këshillit Profesional.

*Message of Director*

Dear readers, I am pleased to present you the DAK annual report for 2011, which aims to inform you about the activities and progress of the DAK in 2011.

The year 2011 was one of the busiest year for DAK, featured with various activities in terms of legislation drafting and increase of professional performance, improvement of quality management system in order to advance DAK as the Accreditation Body in the region and worldwide. Regarding draft and enforcement of the primary and secondary legislation, during the first three months period in 2011 we amended Accreditation Law No 03/L-069, which has been harmonized with Regulation 765/2008. The amended Accreditation Law has this number now: 04/L 007. Administrative Instruction on Accreditation Council and Regulation of the Professional Council have been drafted the same year.

Ndërkaq, në maj të këtij viti DAK iu nënshtrua procesit të para-vlerësimit nga grupi i vlerësuesve të EA. Grupi i vlerësimit dha konkluzionet dhe gjetjet, të cilat ishin inkurajuese për DAK-në.

Pas përfundimit të vlerësimit nga grupi i EA, stafi i DAK-se vazhdoi me punën duke pasur si synim avancimin e përgatitjes së dokumentacionit të SMC, në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17011 dhe kërkesat e EA-së, IAF dhe ILAC, përmes ndërmarrjes së masave përmirësuese të nevojshme në një afat sa më të shkurtër.

Më 23 dhe 24 Nëntor 2011 në Varshavë të Polonisë u mbajt Asambleja Gjenerale e 28 e Ko-operimit Evropian të Akreditimit (EA) ku në mënyrë ceremoniale Drejtorja e Akreditimit e Kosovës nënshkroi kontratën për Anëtar Shok (Associate Member) me EA (European co-operation for Accreditation).

Rritja e cilësisë së Shërbimit të Akreditimit është objektiv kryesor i DAK-së dhe në rritjen e cilësisë së shërbimit të akreditimit pati rol të rëndësishëm edhe bashkëpunimi me të gjitha palët e interesuara kështu që edhe bashkëpunimi rajonal dhe Evropian janë prioritete madhore për DAK, sepse ato janë në funksion të procesit të Integritimit Evropian dhe mbështesin zhvillimin institucional të vetë DAK-së. Përmes këtij bashkëpunimi arrihet edhe këmbimi i njohurive dhe eksperiencës, të cilat ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve në DAK dhe avancimin e më tej të infrastrukturës së cilësisë në Kosovë.

---

In May 2011, DAK underwent the pre-assessment process by the EA assessment team. The assessing group gave its conclusions and findings, which were encouraging for DAK.

After conclusion of assessment by the EA assessment team, DAK carried on with its work aiming to advance the preparation of the QMS documents in accordance to requirements of ISO/IEC 17011 standard and requirements of EA, IAF and ILAC, by undertaking necessary improvement measures within the short period. The 28<sup>th</sup> EA General Assembly was held on 23<sup>rd</sup> and 24<sup>th</sup> of November in Warsaw, Poland and Directorate of Accreditation of Kosovo solemnly signed the Associate Member Contract with EA (European co-operation for Accreditation).

Increase the quality of accreditation services is the main goal of DAK. Cooperation with all interested parties have had a good impact on increase the quality of accreditation services and therefore regional and European cooperation are major priorities for DAK as they are in service of European Integration and support institutional development of the DAK itself. Exchange of knowledge and experience, which help DAK to increase its capacities and further advancement of the quality infrastructure in Kosovo, is also achieved through this cooperation.

Institucionalizimin e këtij bashkëpunimi DAK e ka arritur nëpërmjet nënshkrimit të disa memorandumeve të mirëkuptimit me simotrat e saj, konkretisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA) të Republikës së Shqipërisë, pastaj me Institutin e Akreditimit të Republikës së Maqedonisë (IARM), me Agjencinë Kroate të Akreditimit (HAA) dhe së fundi edhe me Agjencinë Turke të Akreditimit (TURKAK).

Nga ky këndvështrim ne e vlerësojmë këtë vit si vit të suksesshëm të DAK-se dhe theksojmë se të gjitha këto arritje nuk do mund të realizoheshin pa punën dhe bashkëpunimin e stafit të DAK-së, Këshillit të Akreditimit, Vlerësueseve Teknik dhe Komiteteve Teknikë, andaj shfrytëzoj rastin dhe i falënderoj për gjithë angazhimin dhe kontributin e dhënë në këtë drejtim.

---

DAK reached this cooperation by signing several memorandums of understanding with different institutions of same fields such as General Accreditation Directorate (DPA) of Republic of Albania, Accreditation Institution of Republic of Macedonia (IARM), Croatian Accreditation Agency (HAA) and Turkish Accreditation Agency (TURKAK).

From this point of view, we consider 2011 as a successful year for the DAK and I would like to stress out that all these successes would not have been achieved without the work and cooperation between the DAK, Accreditation Council, Technical Assessors and Technical Committees. Therefore, I use this opportunity to thank all for their commitment and contribution in this matter.

*Performanca dhe arritjet në Drejtorinë e Akreditimit*

Drejtoria e Akreditimit bazuar në legjislacionin në fuqi për akreditim dhe gjithnjë në zbatim të planit të punës dhe me qëllim të realizimit të objektivave të vitit 2011, ka vazhduar me mirëmbajtjen, implementimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (SMC) sipas standardit SK EN ISO/IEC 17011, dhe me këtë rast janë kontrolluar, rishikuar dhe po implementohen këto dokumente:

Manuali i cilësisë : DAK-MC-001

Politikat: DAK-PO-001 deri DAK-PO-009

Procedurat e menaxhimit : DAK-PM-001 deri DAK-PM-016

Procedurat teknike: DAK-PT-001 deri DAK-PT-010

Format e sistemit të cilësisë: DAK-FO-001 deri DAK-FO-066

Janë zhvilluar dhe avancuar skemat për akreditimin e:

- a. Laboratorëve testues,
- b. Laboratorëve kalibrues,
- c. Organeve inspektues dhe
- d. Organeve certifikues

---

*Performance and achievements of the Accreditation Directorate*

In accordance to applicable accreditation legislation and in order to achieve the objectives for 2011, Accreditation Directorate carried on maintenance, implementation and continues improvement of Quality Management System (QMS) according to SK EN ISO/IEC 17011 standards and the following documents have been checked, reviewed and implemented:

Quality manual: DAK-MC-001

Policy: DAK-PO-001 to DAK-PO-009

Management procedures: DAK-PM-001 to DAK-PM-016

Technical procedures: DAK-PT-001 to DAK-PT-010

Quality system forms: DAK-FO-001 to DAK-FO-066

Schemes for accreditation of the following bodies have been developed and advanced:

- a. Testing laboratories,
- b. Calibration laboratories,
- c. Inspection bodies and
- d. Certification bodies

Gjatë këtij viti kanë vazhduar aktivitetin:

- ✓ Këshilli i Akreditimit,
- ✓ Komiteti teknik për Laboratorë Testues, Kalibrues,
- ✓ Komiteti teknik për Organe Inspektues dhe Certifikues.

Po ashtu gjatë këtij viti janë kryer procedurat e vlerësimit dhe janë akredituar 2 OVK (Organe për Vlerësimin e Konformitetit), të dyja laboratorë testues dhe atë:

- ✚ Laboratori Analitik, Bujqësor dhe i Ushqimit, Korporata Fito-sanitare „Sara & Meti“.
- ✚ Kontrolli i cilesise se produkteve farmaceutike “Trepharm Laboratory”

The following bodies have carried on their activities:

- ✓ Accreditation Council,
- ✓ Technical Committee for testing and calibration laboratories,
- ✓ Technical Committee for Inspection and Certification Bodies.

Assessments procedures have been conducted and two Conformity Assessment Bodies (CAB's) (both testing laboratories) have been accredited this year. The following testing laboratories have been accredited:

- ✚ Analytic, Agricultural and Food Laboratory, Phyto-sanitary Corporation „Sara & Meti“.
- ✚ Quality control of pharmaceutical products “Trepharm Laboratory”



Momente gjatë vlerësimit në Laboratorin “Trepharm laboratory”  
Moment's during the assessment at Laboratory “Trepharm laboratory”



Dhënia e certifikatave të akreditimit në mënyrë solemne: Korporata Fito-sanitare “Sara&Meti”, - Laboratori Analitik, Bujqësor dhe i ushqimit.

Gjatë këtij viti DAK pati edhe procedurën e vlerësimit për zgjerimin e fushës së akreditimit të Laboratorit N.Sh.”Agrovet” për analizat e mbetjeve të pesticideve në ushqimet me origjinë bimore dhe shtazore, toka ,dheu,uji industrial dhe uji për ujitje,vajrat dielektrike si dhe marrja e mostrave.

Përveç kësaj në procedure të akreditimit janë edhe pesë Organe për Vlerësim të Konformitetit prej tyre tre Laboratorë Testues, një Trupë Inspektues dhe një Organ Certifikues.

1. Eurolab NTP, Laboratori për analiza te ujit,dheut, mineraleve dhe plehrave,
2. Laboratori doganor, Laborator i naftës dhe derivateve te naftës
3. MBPZHR-IBK, Laboratori për analiza te farërave dhe plehrave
4. UBT, Akreditimi i trupave inspektues
5. UBT, Akreditimi i trupave certifikues

During this year, DAK conducted also the assessment procedures for expansion of the accreditation field of Laboratory SOE ”Agrovet” for analyzing pesticide residues in fruit and vegetables and animal products, soil, industrial and irrigation water, dielectric oils as well as taking of samples.

Besides, the following five Conformity Assessment Bodies, three testing laboratories, one inspection body and one certification body are undergoing the accreditation procedures:

1. Eurolab NTP, Laboratory for water, soil, minerals and fertilisers analysis
2. Customs laboratory, diesel fuel and diesel fuel derivatives laboratory,
3. MBPZHR-IBK, Laboratory for seeds and fertilisers analysis
4. UBT, Accreditation of inspection bodies
5. UBT, Accreditation of certification bodies

Ndër procedurat shumë të rëndësishme në Drejtorinë e Akreditimit të Kosovës është procedura e rregullt e mbikëqyrjes së OVK-ve. Gjatë këtij viti kemi kryer mbikëqyrjen e këtyre OVK-ve:

1. Qendra e Laboratorëve Testuese në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë në Kosovë
2. Laboratori për analiza të fijeve të armatues dhe njejve të saldimit “FAN” Sh.p.k
3. Trupa inspektues tipi A KPU Inspekt.
4. “MS Laboratory” për analiza të miellit dhe produkteve të tij “M&Sillosi” Sh.p.k
5. Laboratori për analiza fiziko-mekanike të betonit dhe produkteve të betonit N.P.N “Renelual Tahiri” Sh.p.k
6. Laboratori Analitik, Bujqësor dhe i Ushqimit në Korporatën Fito sanitare Sara & Meti, Sh.p.k Prishtine
7. Laboratori i materialeve të ndërtimit “Vëllezërit e Bashkuar” Sh.p.k
8. Laboratori për analiza të naftës dhe derivateve të naftës “Derivati” Shpk

---


One very important procedure for Directorate of Accreditation of Kosovo is regular procedure for supervising the following Conformity Assessment Bodies:

1. Centre of Testing Laboratories at Kosovo National Health Institute
2. Laboratory for analysis of rebar and welding knuckle-joint “FAN” Sh.p.k
3. Inspection body type A KPU.
4. “MS Laboratory” for analysis of flour and its products “M&Sillosi” Sh.p.k
5. Laboratory for physical-mechanical analysis of concrete and its products N.P.N “Renelual Tahiri” Sh.p.k
6. Analytic, Agricultural and Food Laboratory, Phyto-sanitary Corporation „Sara & Meti Sh.p.k Prishtine
7. Laboratory of construction materials “Vëllezërit e Bashkuar” Sh.p.k
8. Laboratory for analysis of diesel fuel and its derivatives “Derivati” Shpk

Gjithashtu gjatë këtij viti DAK ka bërë para-vlerësimin e këtyre OVK-ve:

1. Vizita para-vlerësuese në laboratorin e kompanisë për prodhimin e qumështit dhe produkteve të tij “Magice”
2. Vizita para-vlerësuese në laboratorin e kompanisë për prodhimin e qumështit dhe produkteve të tij “Bylmet”
3. Vizita para-vlerësuese në laboratorin për analiza të gëlqerës në “New Lepenc”
4. Vizita para-vlerësues në laboratorin ku kryhen analizat e materialit ndërtimor “Testing&Ing” Prizren
5. Vizita para-vlerësuese në ndërmarrjen për prodhimin miellit “Univerzal Food “ne Fushë Kosovë
6. Kontrolli i dokumenteve dhe vizita para vlerësues ne laboratorin e Institutit Bujqësor të Kosovës (IBK) në Pejë

Si dhe Drejtoria e Akreditimit e Kosovës ka kryer procedurat e vlerësimit të OVK-ve që kanë aplikuar për autorizim sipas kërkesave të UA-së 16/2011.



DAK this year also conducted the pre-assessment procedure of the following Conformity Assessment Bodies:

1. Pre-assessment visits in laboratory of “Magice” company for production of milk and its products
2. Pre-assessment visits in laboratory of “Bylmet” company for production of milk and its products
3. Pre-assessment visits in laboratory for analysis of limestone at “New Lepenc”
4. Pre-assessment visits in laboratory for analysis of construction materials “Testing&Ing” Prizren
5. Pre-assessment visits in company for production of flour “Univerzal Food “ in Fushë Kosovë
6. Checking documents and pre-assessment visits in laboratory of Kosovo Agricultural Institute (KAI) in Pejë

Kosovo Accreditation Directorate completed also the assessment procedure of CAB’s that had applied for authorization under requirements of Administrative Instruction 16/2011.

Trupat për vlerësim të Konformitetit të Akredituara  
 Conformity Accreditation Bodies


| <b>Trupat Inspektues të Akredituar sipas standardit SK EN ISO/IEC 17020</b><br>Accredited Inspection Bodies according to standard SK EN ISO/IEC 17020 |                          |   |
|---|--------------------------|---|
| Kodi  | Emri                     | Fusha e Akreditimit   |
| 06 / 001  | KPU "Inspect"<br>Sh.p.k. | <a href="#">Trupa Inspektuese për naftë dhe derivate të naftës</a><br>Inspection body for oil and crude oil |

| <b>Laboratorët Testues të akredituar sipas standardit SK ISO/IEC 17025</b><br>Accredited Testing Laboratories according to standard SK ISO/IEC 17025 |                         |   |
|--|-------------------------|---|
| 10/002   | NSH "Agrovet"           | Laboratori për analiza të: tokës, mineraleve, hedhurinave industriale dhe indeve bimore. Ujit industrial dhe për ujitje, plehrave artificiale dhe organike<br>Lab. for: soil, minerals, industrial waste and plant tissues<br>Industrial and irrigation water, artificial and natural-organic fertilizers |
| 07/003   | Sharr Beteiligungs GMBH | Laboratori për analiza kimike dhe fiziko-mekanike të çimentos<br>Laboratory for chemical and mechanical-physical analysis of cement   |
| 05/004   | "INKOS" sh.p.k.         | Laboratori i kontrollit të derivateve të naftës<br>Laboratory for analysis oil and crude oil.   |
| 11/005   | "FAN" sh.p.k            | Laboratori për analiza fiziko-mekanike të armaturës dhe njejve të saldimit<br>Lab. for mechanical-physical analysis of armory and soldering   |

|        |  |   |
|--------|--|---|
| 22/006 | N.P.N “Renelual Tahiri” sh.p.k   | Laboratori për analiza fiziko-mekanike për beton dhe produkte të betonit.<br>Laboratory for mechanical-physical analysis of concrete  |
| 21/007 | Compact Group sh.p.k   | Laboratori i analizave të ujit “DEA”<br>Laboratory for analyses of drinking water   |
| 16/008 | Eskavatori Company sh.p.k  | Laboratori i analizave të agregateve, përzierjes bituminoze dhe bitumit<br>Laboratory for asphalt and aggregates  |
| 12/009 | SHPK “M&Sillosi”   | Laboratori për analiza të grurit, miellit dhe produkteve nga mielli<br>Flour, corn, bran and corn products analyses laboratory  |
| 15/010 | “Derivati” Sh.p.k  | Laboratori për analiza të naftës dhe derivateve të naftës<br>Laboratory for analyses of petroleum and derivate of petroleum   |
| 18/011 | N.N.SH “Geokos” A&A  | Laboratori për analizat gjeomekanike të dherave gjate shpumjeve në tokë<br>Laboratory for analyses for geo – mechanics of soil  |
| 13/012 | N.T.P.”Ballkan Petroll”  | Laboratori për analiza të vajrave<br>Oil analyses laboratory  |
| 29/013 | Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës- Qendra e Laboratorëve Testuese | 1.Laboratori për analiza të ujit të pijes dhe ujërave rekreativ<br>2. Laboratori i kontrollit të cilësisë së ushqimit<br>3. Laboratori mikrobiologjik i ushqimit dhe uji<br>1.Laboratory for physical-chemical testing of drinking and recreational water<br>2.Food quality control laboratory<br>3.Microbiological laboratory for water and food testing |
| 23/014 | N.P.T.SH “Vëllezërit e Bashkuar”Sh.p.k.  | Laboratori i materialeve të ndërtimit   |

|        |   |   |
|--------|---|---|
|        |   | Laboratory for analyses of concrete and concrete products   |
| 33/015 | N.P.N“Ballkan Projekt”                        | Laboratori për shqyrtimin e materialit ndërtimor, beton,asfalt si dhe hulumtime gjeomekanike dhe gjeologjike te dherave                   |
| 34/016 | Korporata Fito sanitare „Sara & Meti“, sh.p.k | Laboratori Analitik, Bujqësor dhe i Ushqimit<br>Analytical Laboratory, Agricultural and Food  |
| 36/017 | Fabrika për prodhime farmaceutike „Trepfarm“  | Kontrolli i cilesise se produkteve farmaceutike “Trepfarm Laboratory”<br>Quality control of pharmaceutical products “Trepfarm Laboratory” |

Paraqitja grafike e OVK-ve të akredituar për vitet 2008-2011  
Graphical representation of CABs accredited for 2008-2011



*Bashkëpunimi në nivelin Evropian dhe Ndërkombëtarë i DAK-së*

DAK merr pjesë në aktivitet ndërkombëtare si dhe bashkëpunon me organizmat e akreditimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Më 23 dhe 24 Nëntor 2011 në Varshavë të Polonisë u mbajt Asambleja Gjenerale e 28 e Ko-operimit Evropian të Akreditimit (EA) ku në mënyrë ceremoniale Drejtoria e Akreditimit e Kosovës nënshkroi kontratën për Anëtar Shok (Associate Member) me EA.



Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës (DAK) z.Ibush Luzha me Kryetarin e Ko-operimit Evropian të Akreditimit (EA) z.Graham Talbot

Në emër të EA-së kontratën e nënshkroi kryetari i Ko-operimit Evropian të Akreditimit z.Graham Talbot, ndërsa në emër të Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës nënshkroi Drejtori i DAK-së z.Ibush Luzha.

*Cooperation of DAK at European and international level*

DAK participates in international activities and cooperates with accreditation institutions at regional and international level.

The 28<sup>th</sup> EA (European co-operation for Accreditation) General Assembly was held on 23<sup>rd</sup> and 24<sup>th</sup> of November in Warsaw, Poland and Kosovo Accreditation Directorate solemnly signed the Associate Member Contract with EA (European co-operation for Accreditation).

Chairman of European co-operation for Accreditation, Mr Graham Talbot, signed the contract on behalf of EA while Mr. Ibush Luzha signed the contract on behalf of the DAK.



Ky statusi DAK-ut i hap rrugën e nënshkrimit të marrëveshjeve të njohjes reciproke (MLA), e cila ka për qëllim mbështetjen e tregtisë së lirë nëpërmjet reduktimit të barrierave teknike në tregti. Garantohet lëvizja e lirë mallrave pa pasur nevojën e ri-testimit, apo ri-kalibrimit në laboratorët e vendit ku hyn. Në këtë mënyrë bazuar në parimin „**një produkt i testuar njëherë, pranohet kudo**“ realizohet qëllimi për lëvizjen e lirë të produkteve me minimumin e kostove dhe të përpjekjeve.

Drejtoria e Akreditimit e Kosovës ka pasur para-vlerësimin për marrëveshjen Multilaterale të EA-së për Laborator Testues nga vlerësuesit e EA-së për nënshkrimin e Marrëveshjes Multilaterale me EA. Para-vlerësimi u realizua më 17,18 dhe 19 Maj 2011.

Pas një periudhe të caktuar krye-vlerësuesja e EA-së na ka dërguar raportin e jokonformiteteve.



Momente gjatë para-vlerësimit t nga të EA-së

Such status opens the way to DAK to sign the multilateral agreement contract (MLA), which aims to provide support to free market through reduction of technical barriers in market.

Such agreement guarantees free movement of goods without having to retest or recalibrate the goods in laboratories of the country where the goods enter. In this way, based on the principle “**a product tested once is accepted everywhere**”, free movement of products is achieved with minimum costs and efforts.

EA assessors have conducted the pre-assessment procedure at Directorate of Accreditation of Kosovo for signing the EA Multilateral Agreement concerning Testing Laboratories. The pre-assessment took part on 17<sup>th</sup>, 18<sup>th</sup> and 19<sup>th</sup> of May 2011.

The EA Head assessor sent us an unconformity report after a certain period.



Vlerësueset e EA-së, znj.Nicole Vanlaethem dhe znj.Tsvetanka Zaharieva

DAK tani më ka dërguar të gjitha dokumentet e rishikuara të kërkuara nga vlerësuesja e EA-së dhe përgjigjet në pyetjet e kërkuara, dhe është në pritje të përgjigjes së radhës. Pas zgjidhjes së të gjitha jo-konformiteteve të gjetura DAK do të vlerësohet edhe një herë nga ana e vlerësuesve të EA-së dhe më pastaj do të bëhet nënshkrimi i Marrëveshjes Multilaterale (MLA) me EA-në me ç'rast certifikatat e laboratorëve testues të akredituara nga DAK do të pranohen nga të gjitha shtetet që kanë nënshkruar MLA me EA, ILAC dhe IAF.

Drejtoria e Akreditimit e Kosovës vazhdon të ketë statusin , si anëtare me të drejtë vote me Organizatën Ndërkombëtare të Akreditimit të Laboratorëve (ILAC). Ky status i jep të drejtën DAK-ut që jo vetëm të marrë pjesë në aktivitetet e Organizatës Ndërkombëtare të Akreditimit të Laboratorëve- ILAC, por edhe të votojë në për çështjet e ndryshme lidhur me procedurat e akreditimit.

---


DAK has already sent all reviewed documents and replied to questions of the EA Head assessor and is waiting for answer. Upon resolution of all unconformities that have been found, the EA assessors shall assess the DAK once again and then the Multilateral Agreement (MLA) shall be signed with EA and certificates of the testing laboratories accredited by the DAK shall be accepted by all countries that have signed the EA MLA, ILAC and IAF.

Directorate of Accreditation of Kosovo retains to have the status of the member with the right to vote with International Laboratory Accreditation Cooperation (ILAC). This status enables DAK not only to attend the activities of International Laboratory Accreditation Cooperation (ILAC) but also to vote for various matters regarding the accreditation procedures.

Gjithashtu duke u bërë anëtare me të drejta të plota në Forum Ndërkombëtar (IAF), DAK bëhet pjesë e të gjitha programeve që IAF ka për trupat akreditues. Konkretisht merr pjesë në aktivitetet e IAF, shkëmben informacion dhe eksperiencë me trupat akreditues anëtar, etj.

DAK-u i ka kushtuar rëndësi të madhe marrëdhënieve rajonale dhe ka raporte të mira me të gjithë Organet e Akreditimit të shteteve në rajon. DAK-u ka nënshkruar Memorandume mirëkuptimi (MoU-en) me Institutin e Akreditimit nga Republikën e Maqedonisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit nga Republika e Shqipërisë, Agjencinë e Akreditimit TURKAK nga Turqia, Agjencinë e Akreditimit nga Kroacia ndërsa së shpejti do të nënshkruhet edhe MoU-en me Organin e Akreditimit nga Mali Zi.

Në një raport vlerësimit të OECD-es në takimin e CEFTA-s për Barrierat Teknike të Tregtisë që u mbajt me 3 Nëntor të vitit 2011 në Budapest të Hungarisë Fushë Veprimtarisë së Akreditimit për infrastrukturën e cilësisë ju dha vlerësimi më i lart për Kosovën.



Being full member of International Accreditation Forum (IAF), DAK becomes part of all programs that IAF has with the accreditation bodies. DAK, actually, participates at IAF activities, exchanges information and experiences with the accreditation bodies, etc.

DAK has paid attention to regional relationships and has good relationship with all Accreditation Bodies of countries in the region. DAK has signed the Memorandum of Understanding (MoU) with Accreditation Institution of Republic of Macedonia, General Accreditation Directorate of Republic of Albania, Turkish Accreditation Agency TURKAK, and Croatian Accreditation Agency and soon will sign the Memorandum of Understanding with accreditation Body of Montenegro.

During the CEFTA meeting on Technical Barriers in Market held on 3<sup>rd</sup> of November 2011 in Budapest, Hungary an assessment report of OECD assessed the Kosovo accreditation activities and accreditation infrastructure with the highest score

### *Trajnimet e stafit, vlerësuesit dhe ekspertet teknik*

DAK deri me tani ka organizuar mbi 43 trajnime ne standardet ISO 9001, ISO/IEC 17011, ISO/IEC 19011, ISO/IEC 17020, ISO/IEC 17021, ISO/IEC 17024, ISO/IEC 14001, ISO/IEC 17025 etj. me mbi 700 pjesëmarrës si nga Organet për Vlerësim të Konformitetit ashtu edhe nga Infrastruktura e Cilësisë. Pas çdo trajnimi u shpërndan certifikata të ndjekjes së trajnimeve.

DAK ka me shume se 36 ekspert në lëmi të ndryshme, 7 krye vlerësues dhe 8 vlerësues të cilët i angazhon në procedurat e akreditimit. Gjithashtu bashkëpunon me të gjitha Organet Kombëtare të Akreditimit në rajon në shkëmbimin e krye vlerësuesve, vlerësuesve dhe ekspertëve në procedurat e akreditimit.

Një nga objektivat e DAK-së është rritja dhe përmirësimi i kompetencës së stafit dhe vlerësuesve teknik nëpërmjet trajnimit. Kjo u arrit nën përkrahjen e projektit IPA 2008 dhe PTB. Trajnimet gjatë vitit 2011 u organizuan si më poshtë:

Më 9,10 Shkurt 2011 në ATC (Trupi Akreditues i Serbisë), i mbështetur nga projekti PTB, (Institutit Gjerman i Metrologjisë): "Promovimi i Bashkëpunimit Rajonal në Evropën Juglindore në fushën e infrastrukturës së cilësisë," në Beograd u mbajt trajnimi : Vlefshmëria dhe verifikimi-Kërkesat e Standardit ISO/IEC-17025, Vlefshmëria në mikrobiologji dhe Llogaritja e pasaktësisë së pajisjeve në Kimi.

---

### *Training of staff, Assessors and Technical Experts*

DAK so far has organized over 43 trainings on ISO 9001, ISO/IEC 17011, ISO/IEC 19011, ISO/IEC 17020, ISO/IEC 17021, ISO/IEC 17024, ISO/IEC 14001, ISO/IEC 17025 etc. standards with over 700 participants of Conformity Assessment Bodies and Quality Infrastructure. DAK issued certificates to all participants of the trainings.

DAK has over 36 experts of various fields; it has 7 Lead assessors and 8 assessors who are engaged on the accreditation procedures. DAK also cooperates with all National Accreditation Bodies in the region in exchanging Lead assessors, assessors and experts of the accreditation procedures.

One of the DAK goals is to increase and improve the competences of the staff and technical assessors through various trainings. This was achieved through IPA 2008 and PTB projects. The following trainings were organized in 2011: Training "Validity and verification – Requirements of ISO/IEC-17025 Standard, Validity in microbiology and Calculation of inaccuracy of equipments in chemistry" was held at ATC (Accreditation Body of Serbia) on 9<sup>th</sup> and 10<sup>th</sup> of February 2011, supported by PTB project (German Metrology Institute): "Promotion of regional cooperation in south east Europe in the field of quality infrastructure".

Më 24,25 Shkurt 2011 në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit në Tiranë u mbajt trajnimi “Eksperiencat për përgdatitjen e procedurave të para-vleresimit nga vlerësues të EA-së (European co-operation for Accreditation) që do të i bëhet DAK-ut në Majin e vitit 2011.

Me 7 dhe 8 Mars të vitit 2011 u mbajt trajnimi HOT 3/6 The official responsible for developing/updating authorization/designation/notification procedures for CABs in the New Approach and related legislative areas i cili u mbajt në Vienë të Austrisë, organizator dhe mbështetës i këtij trajnimi ishte IPA 2008. Diskutimet ishin të ndryshme dhe vështirësi patëm me qasjen që i jepte kësaj problematike delegacioni nga Bosnja dhe Hercegovina si dhe delegacioni nga Mali i Zi. Ne si delegacion ishim në përputhje me ndryshimet që janë bërë në legjislacionin e Bashkimit Evropian konkretisht rregulloreve 764/2008, 765/2008 dhe Urdhëresën 768/2008 të Komisionit Evropian të cilat flasin për autorizimin respektivisht për Trupat Notifikuese.

Më 11-13 prill 2011 në Ankara të Turqisë, u morr pjesë në trajnimin: Proceset e përgjithshme të akreditimit. Edhe ky trajnim po ashtu ishte i mbështetur nga projekti PTB. Gjatë këtij trajnimi u arritën njohuri të reja për procesin e akreditimit përmes shkëmbimit të eksperiencës mes organizmave të tjerë të akreditimit të vendeve të rajonit.

---

Training “Experiences for preparation of pre-assessment procedures by the EA (European co-operation for Accreditation) Assessors” to be conducted to DAK in May 2011, was held at General Accreditation Directorate in Tirana on 24<sup>th</sup> and 25<sup>th</sup> of February 2011.

Training HOT 3/6 “The official responsible for developing/updating authorization/designation/notification procedures for CABs in the New Approach and related legislative areas” was held in Vienna, Austria on 7<sup>th</sup> and 8<sup>th</sup> of March 2011. IPA 2008 organized and supported the training. The training was featured with various discussion and we had difficulties with the approach of delegations of Bosnia and Herzegovina and Montenegro. Our delegation supported the changes made to the European Union legislation, respectively regulation 764/2008 and 765/2008 and Ordinance 768/2008 of European Commission related to the authorization, respectively to Notification Bodies.

From 11<sup>th</sup> to 13<sup>th</sup> of April 2011, in Ankara, Turkey, DAK officer participate at the training “General Accreditation processes”. This training was also supported by PTB. During the training, there was possibility to receive new knowledge for the accreditation process through exchange of experience between other accreditation institutions of countries of the region.

Më 15-16 Qershor 2011 në Athinë të Greqisë u mbajt trajnimi: Procedura e vlerësimit në Laboratorin e biologjisë molekulare sipas standardit ISO/IEC 15189. Fusha e akreditimit i këtij laboratorit ishte: analizat e gjakut, proteinave, sëmundjeve kancerogjene dhe analizat tjera biokimike sipas metodave DNA, RT-PCR, LICHT CYCLER20 (ROCHE).

Më 29-30 qershor 2011 në Shkup, Maqedoni (IARM -Instituti i Akreditimit i Republikës së Maqedonisë) i mbështetur nga Bashkimi Evropian në Shkup të Maqedonisë u mbajt trajnimi në standardin EN 54011 "Kërkesat e përgjithshme për trupat certifikues të produkteve" dhe IAF GD 5:2006.

Trajnimi u realizua në kuadër të projektit: "Technical Assistance for capacity building of the Institute of Accreditation (IARM)" nga Trupi Certifikues BAM nga Gjermania.

Më 4 deri 6 tetor 2011, në Shkup të Maqedonisë u mbajt trajnimi: Vlerësimi i Gjurmueshmërisë në Laboratorët Testues. Trajnim ishte i mbështetur nga projekti PTB.

Gjatë këtij trajnimi u prezantuan tema të ndryshme që kishin të bënin me gjurmueshmërinë e matjeve në laboratorë testimi, kërkesat e standardit ISO / IEC 17011 dhe ISO / IEC 17025.

---

Training "The assessment procedure in molecular biology laboratory according to ISO/IEC 15189 standard" was held in Athens, Greece on 15<sup>th</sup> and 16<sup>th</sup> of June 2011. The accreditation field of that laboratory was: blood analysis, proteins analysing, cancer, and other biochemical analysis according to DNA, RT-PCR, LICHT CYCLER20 (ROCHE) methods.

Training on EN 54011 standard "General requirements for bodies operating product certification" and IAF GD 5:2006 was held in Skopje, Macedonia (Accreditation Institute of Republic of Macedonia). This training was supported by office of European Union in Skopje and was held on 29<sup>th</sup> and 30<sup>th</sup> of June 2011.

The training was organized within the project: "Technical Assistance for capacity building of the Institute of Accreditation (IARM)" by BAM Certification Body from Germany.

Training "Assessment on traceability in Testing Laboratories" was held in Skopje, Macedonia from 4<sup>th</sup> to 6<sup>th</sup> of October 2011. The training was supported by PTB project.

Various topics related to traceability of measurements in testing laboratories and requirements of ISO / IEC 17011 and ISO / IEC 17025 standards were presented during the training.

Më 22 deri 24 Nëntor 2011, i mbështetur nga projekti PTB, (Institutit Gjerman i Metrologjisë): "Promovimi i Bashkëpunimit Rajonal në Evropën Juglindore në fushën e infrastrukturës së cilësisë," në Stamboll të Turqisë u morr pjesë si vëzhgues në vlerësimin e Trupës për Certifikim të produktit.

Më 19 deri 21 dhejtor 2011 i mbështetur nga projekti PTB, (Institutit Gjerman i Metrologjisë): në Athinë të Greqisë u mbajt trajnimi "EA 2/17 and New Approach Directives". Ku u prezantuan direktivat: **Direktiva 95/16/EC –për lifta**, Fusha e Akreditimit; **Direktiva për Makineri 2006/42/EC**, Fusha e Akreditimit; **Guida e EA-së 2/17**-Mbi kërkesat horizontale të akreditimit të trupave për vlerësim të konformitetit për notifikim, Direktiva për enët nën presion- Directive **97/93/EC PED** (Pressure Equipments Directive), Guida EA 2/17 përmban kritere horizontale për organet e vlerësimit të konformitetit të cilat kërkojnë të akreditohen.

---

Officer from DAK attended the training "Promotion of regional cooperation in south east Europe in the field of quality infrastructure" as observer in assessment of the Body for product certification. The training was held in Istanbul, Turkey from 22<sup>nd</sup> to 24<sup>th</sup> of November and was supported by PTB project (German Metrology Institute).

"EA 2/17 and New Approach Directives" training was held in Athens, Greece from 19<sup>th</sup> to 21<sup>st</sup> of December 2011. The training was supported by PTB project (German Metrology Institute). **Directive 95/16/EC –for lifts**, Accreditation Field; **Directive 2006/42/EC on Machinery**, Accreditation Field; **EA Guide 2/17** on the horizontal requirements for the accreditation of conformity assessment bodies for notification purposes; Directive on pressure equipments - Directive **97/93/EC PED** (Pressure Equipments Directive), EA Guide EA 2/17 contains the horizontal requirements for conformity assessments bodies wishing to be accredited.

*Takimet rajonale të DAK-ut*

Më 7 dhe 08 Shkurt 2011 në Budapest të Hungarisë u mbajt takimi “Networking of experts and assessors for accreditation activity” të cilin e organizoi IPA 2008. Qëllimi i takimit ishte që të vazhdohet me krijimin e një rrjeti të vlerësuesve teknik në nivel të rajonit edhe në momentin që ndonjë organizëm akreditues i një shteti nga këta pjesëmarrës ka nevojë për vlerësues, futet në rrjet dhe merr informacionin e duhur. U bisedua edhe për kriteret e ekspertëve teknik respektivisht vlerësuesve. U diskutua edhe për plotësimin e kërkesave të rregulloreve të EA, IAF dhe ILAC. U diskutua edhe për dokumentet: ILAC-G3, ELA-G7, ELA-G10, ILAC-G11:07 dhe EAL-G8.

Më 08-11.05.2011 në Zagreb të Kroacisë u mbajt takimi i radhës, HOT 14 ku u vazhdua me diskutimin e kriterëve për vlerësues dhe ekspert teknik për të ngritur rrjetin e tyre në rajon. Tashmë u punua dhe u përfundua drafti final të “Common Requirements for the Regional Assessors in SEE Region” (harmonizimi i proceduarave për selektimin, trajnimin dhe autorizimin e vlerësuesve dhe ekspertëve teknik në rajon).

*Regional meetings of the DAK*

Meeting “Networking of experts and assessors for accreditation activity”, organized by IPA 2008, was held on 7<sup>th</sup> and 8<sup>th</sup> of February 2011 in Budapest, Hungary. The goal of the meeting was to continue to establish a network of technical assessors in regional level and in case an accreditation institution of countries participating the meeting is in need for an assessor, it has access to the network and obtains the needed information. Another topic that was discussed in the meeting was supplementation of requirements of the EA, IAF and ILAC regulations. Documents ILAC-G3, ELA-G7, ELA-G10, ILAC-G11:07 and EAL-G8 were also discussed during the meeting.

Meeting HOT 14 was held in Zagreb, Croatia, from 8<sup>th</sup> to 11<sup>th</sup> of May 2011. The goal of the meeting was to continue with the discussion about the requirements of assessors and technical experts to establish their network in the region. Final draft “Common Requirements for the Regional Assessors in SEE Region” (harmonization of procedure for selection, training and authorization of assessors and technical experts in the region) has been finalized.

Më 28 dhe 29 Shtator 2011 në Ohër të Maqedonisë u mbajt takimi rajonal i Drejtorive, Agjencive dhe Instituteve të Akreditimit të shteteve të rajonit. U bisedua për legjislacionin, procedurat e vlerësimit të konformitetit si dhe mundësin e nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale në mes shteteve në njohjen e certifikatave për vlerësim të konformitetit deri në periudhën e nënshkrimit të MLA (Marrëveshjes Multilaterale) me EA (European co-operation for Accreditation). U njoftuam se deri tani ishte nënshkruar kjo marrëveshje mes Serbisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës. Gjithashtu u prezantuan edhe dy softuer për Trupat Akreditues, prodhues të softuerëve ishin ekspert të IT-ve nga Maqedonia dhe Serbia. Gjatë këtij takimi kisha një prezantim në emër të DAK mbi gjendjen e DAK, numrin e OVK-ve të akredituara dhe mbarëvajtjen e para vlerësimit të vlerësuesve të EA-së me 16-19 Maj 2011.


Më 17-19 Tetor 2011 në Bratislavë të Sllovakisë u mbajt takimi i Korporatës Evropiane të Akreditimit, Këshilli për Marrëveshje Multilaterale (EA MAC). Takimet e para i filluam me raportimet dhe vlerësimet që ishin bërë nga vlerësues të EA-së, Trupave Akredituese. Ishin gjithsej katërbëdhjetë raporte të vlerësimit.

---

Meeting of regional Accreditation Directorate, Agencies and Institutions of countries of the region was held on 28<sup>th</sup> and 29<sup>th</sup> of September 2011 in Ohër, Macedonia. Legislation, conformity assessment procedures and possibility to sign mutual agreements between countries for recognition of conformity assessment certificates until the period when Multilateral Agreement (MLA) is signed with EA (European co-operation for Accreditation) were among the topics that were discussed during the meeting. We were notified that such agreement had been already signed between Serbia and Bosnia and Herzegovina. Two software programs for Accreditation Bodies have been presented during the meeting. The software programs have been produced by the IT experts of Macedonia and Serbia. I held a presentation on behalf of the DAK on general situation of the DAK, number of accredited Conformity Assessment Bodies and course of the pre-assessment of the EA assessors on 16<sup>th</sup> to 19<sup>th</sup> May 2011.

Meeting of the European Accreditation Corporation, EA Multilateral Agreement Council (EA MAC) was held in Bratislava, Slovakia, from 17<sup>th</sup> to 19<sup>th</sup> of October 2011. The meeting began with reporting and assessments that had been conducted by the EA assessors to the Accreditation Bodies. There were fourteen assessment reports in total

*Organograma e Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës*  
*Organgram of the Directorate of Accreditation of Kosovo*



## *Materialet promovuese*

Gjatë vitit 2011 DAK realizoi përgatitjen e materialeve të mëposhtme:

1. Raportin Vjetor 2010,
2. Buletin informativ të DAK-së
3. Broshura e DAK-së

## *web faqja*

DAK nëpërmjet ueb faqes [www.dak-ks.org](http://www.dak-ks.org) i shpërndan informacionet e rëndësishme për akreditimin, njoftimet për aktivitete, informacionet për fushat e akreditimit,

---

## *Promotional materials*

DAK managed to prepare the following materials in 2011:

1. Annual report of 2010,
2. The DAK's information bulletin
3. The DAK's brochure

## *Website*

DAK releases important information about accreditation, activities and other information related to accreditation scope through website [www.dak-ks.org](http://www.dak-ks.org).

*Shtypi ditor shkruan për Drejtorinë e Akreditimit*  
*The daily press writes about the Accreditation Directorate*

<http://kosova.info/2011/12/drejtoria-e-akreditimit-te-kosoves-anetare-evropiane/>

[http://lajme.parajsa.com/Kosova/id\\_352294/](http://lajme.parajsa.com/Kosova/id_352294/)

<http://lajmonline.com/?nav=24,2&id=683>

<http://www.kohaditore.com/?page=1,3,80039>

<http://www.onlinekosova.com/?id=2&cid=1255#>

<http://www.dak-ks.org/?cid=1,17,22>

<http://www.dak-ks.org/?cid=1,17,17>

<http://www.dak-ks.org/?cid=1,17,16>

<http://www.dak-ks.org/?cid=1,17,35>

<http://www.dak-ks.org/?cid=1,17,32>

<http://www.dak-ks.org/?cid=1,17,36>

<http://www.dak-ks.org/?cid=1,17,45>